



Regional project „Protected Areas for Nature and People II“
is implemented by WWF Adria with support from Swedish
International Development Cooperation Agency (SIDA).

Njoftim për shtyp

5. Qershori – Dita Botërore e Mjedisit

„Është koha për natyrën“

Prishtinë, 5. Qershor 2020. - Dita Botërore e Mjedisit këtë vit shënohet me moton "Është koha për natyrën", dhe tema kryesore është ruajtja e biodiversitetit.

Në këtë datë, WWF Adria thekson se roli kryesor i zonave të mbrojtura është ruajtja e biodiversitetit, por që shpesh është lënë pas dore, duke u fokusuar në shfrytëzim të pa qëndrueshëm të pyjeve, ndërtime dhe turizmin masiv, si dhe aktivitete të tjera të paqëndrueshme.

Znj. **Krenare Salihu**, menaxhere e projektit PA4NP (Protected Areas for Nature and People) nga WWF Adria në Kosovë thekson që zonat e mbrojtura janë të rëndësishme jo vetëm për ruajtjen e biodiversitetit, por edhe për zhvillimin socio-ekonomik, i cili do të jetë në fokus në periudhën e ardhshme për shkak të kthimit gradual në normalitet pas pandemisë së virusit Covid 19. Pra, është kjo krizë globale shëndetësore që duhet të na kujtojë se shkatërrimi i burimeve natyrore do të thotë shkatërrimi i potencialeve të shumta për zhvillimin e qëndrueshëm.

Drejtori i drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri", z. **Bajram Kafexholli** tregon se PK "Sharri" është vazhdimisht i rrezikuar nga prerjet ilegale që paraqesin sfidën dhe problemin kryesor më të cilin është duke ballafaquar kjo zonë.

"Me degradimin e pyjeve, si pasojë e prerjeve ilegale, këto resurse do t'i humbin vlerat natyrore që kanë ndikuar që ato të shpallën si pasuri kombëtare të PK "Sharri". Ky problem është edhe më serioz kur merret parasysh fakti se prerjet ilegale e rrezikojnë ekzistencën biologjike të pyjeve, të cilët paraqesin faktorin kryesor për ekuilibrin ekologjik të mjedisit jetësor" – thekson ai.

Ai gjithashtu, u bënë apel gjithë qytetarëve që vizitojnë parqet kombëtare që i kemi trashëguar nga gjeneratat e mëhershme, por gjithashtu kërkon angazhim dhe përkushtim nga të gjitha institucionet relevante në nivelin qendror, komunal, OJQ etj.

"Vetëm me një aksion të koordinuar të subjekteve qeverisëse dhe shoqërisë civile mund të mbrohen me sukses resurset pyjore nga faktori antropogjen sepse kemi obligim njerëzor, moral, kombëtar dhe ndërkombëtar që t'i mbrojmë dhe t'i lëmë trashëgimi gjeneratave të ardhshme" – përfundon ai.

Drejtorja për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri", në bashkëpunim me WWF Adria në Kosovë kanë shënuar këtë ditë me disa aktivitete në ngritjen e vetëdijës për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit.

WWF – Organizata Botërore e natyrës, është një nga organizatat më të mëdha, të njohura në të gjithë botën, e pavarur, e cila merret me ruajtjen e natyrës dhe ka rreth 5 milion mbështetës dhe një rrjet aktiv global në më shumë se 100 vende. Misioni i WWF është të ndalojë shkatërrimin e mjedisit dhe të krijojë një të ardhme ku njerëzit të jetojnë në harmoni me natyrën përmes ruajtjes së biodiversitetit në botë, përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe uljes së ndotjes dhe konsumit të tepërt. Për më shumë info: wwfadria.org